



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.441/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, Blerta Mahmuti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë e Jugut, Blerta Mahmuti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut, me shenjën ZL.A.nr.441/2017 e datë 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicë e Jugut, Blerta Mahmuti, nga radhët e subjektit politik (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut, me të cilën ka pretenduar se në fshatin Zhabar, shkolla "Shaban Idrizi" Qendra e Votimit 1101B, në fshatin Shipol, shkolla "Fazli Grajcevc" Qendra e Votimit 1003B, në fshatin Bajr shkolla "Ismail Qemaili" Qendra e Votimit 1104B, Suhodoll- shkolla "Aziz Sylejmani", Qendra e Votimit 1106/B, Vaganicë- shkolla "Skenderbeu"- Qendra e Votimit 1105B, Sitnica- shkolla "Bedri Gjina" Qendra e Votimit 1111/B, në fshatin Kqiq i Madh- shkolla "Bislim Imeri" Qendra e Votimit 1112B, në fshatin Gushavc- shkolla "Harush Beka" Qendra e Votimit 1114B, Tuneli i Parë- shkolla "Elena Gjika"- Qendra e Votimit 1116B, në fshatin Kushtovë shkolla "Isuf Rexha" - Qendra e Votimit 1122B, shkolla "Abdullah Shabani" Qendra e Votimit 1102X, shkolla "Migjeni", Qendra e Votimit 1102B parashtruesja e ankesës ka pretenduar se në këto Qendra të Votimit nuk gjinden votat të cilat i kanë pritur secili anëtar i Kuvendit Komunal duke u bazuar në fjalët e dëshmitarëve të secilit anëtar të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Blerta Mahmuti, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.441/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*